

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ FIERI BETON ” shpk

Në Lushnje, sot më datë **11.01.2021**

Z.KOSTANDIN JOTI shtetas shqiptare, me atesi Liu, i datëlindjes 07 gusht 1985 lindur ne Fier, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet pasaportes shqiptare me **nr. 034299943** dhe **nr. personal I508070129M**

me cilësinë e “Ortakut te Vetem Themelues”, me vullnet të lire, të plote e të sinqertë dhe iniciativën e lire private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, vendosen krijimin dhe regjistrimin e shoqërisë “**FIERI BETON ” shpk** me të dhënat e mëposhtme:

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**FIERI BETON ” shpk**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria “**FIERI BETON ” shpk** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në **Qyteti “Lushnje”, Autostrada Lushnje-Fier km 7 Saver. Z. K 3268, Nr. Pasurise 92/13.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



Neni 4

Objekti

Shoqëria kryen aktivitetin e mëposhtëm: Prodhim dhe tregetim betoni dhe materiale ndertimi germim dhe sistemim dheu, muratur e beton arme ,sistemim dhe punime ne toke te germuar , prodhim elemente betoni ndertime civile, industrial ,turistike , bujqesore ,ekonomike, rikonstrukcion objektesh ,kompletim me instalimet e nevojshme per to ,veshje fasade , ndertim banese me skelet mbi 8 kate , punime dhe mirembajtje ,ndertim rrugeshe dhe mbi shtesa rrugore, ura, vepra arti ,kanalizime, ujesjellesa dhe impiante vaditese, izolime mbi dhe nentokesore nga ujerat , themele te vecanta ,import – eksport mallrash te ndryshem industrial , Transportim inertesh , punime druri dhe metalike etj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë. Kapitali perbehet nga nje kuote, pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues eshte **Z.KOSTANDIN JOTI**, lloji i kontributit: ne para dhe vlera e kontributit 100.000 leke; kapitali perbehet nga nje kuote e cila zotërohet ne masen 100 % nga **Z.KOSTANDIN JOTI**

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke.

(2) Kontributet në para jane te paguara plotësisht. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar.

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave të zoteruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- dh) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga administratori. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është **5 (pesë) vjet**, me të drejtë riemërimi. Administrator i shoqërisë zgjidhet **Z.KOSTANDIN JOTI** shtetas shqiptarë me atësi Liu, i datëlindjes 07 gusht 1985 lindur në Fier, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet pasaportes shqiptare me **nr. 034299943** dhe **nr personal I50807129M**

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Kompetencat



Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur:

Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

1. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

2. me vendim të asamblesë së përgjithshme;
3. me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
5. me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e statutit, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 2 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaket themelues të shoqërisë tregtare. “ **FIERI BETON** ” shpk nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

Për regjistrimin e Aktit të Themelimit pranë QKB autorizohet Z. Kostandin Joti i cili mund të kryejnë çdo veprim në lidhje me regjistrimin e Shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

KOSTANDIN JOTI

